



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 34, datë 14.10.2019

PËR

**“PAJISJEN E SIPËRMARRËSIT VODAFONE ALBANIA SH.A ME AUTORIZIM  
INDIVIDUAL PËR PËRDORIM FREKUENCASH NË BREZIN 3600--3800 MHZ  
PËR KËRKIM, MATJE DHE PROVË”**

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), me pjesëmarrjen e:

<b>Z. Ilir Zela</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Znj. Ketrin Topçiu</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Znj. Edlira Dvorani</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Znj. Xhoana Lilaj</b>	<b>Anëtar</b>

dhe sekretare e Këshillit Drejtues Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 14.10.2019, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.7 datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

- *Pajisjen me Autorizim Individual të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a për përdorim frekuencash në brezin 3600-3800 MHz, për kërkim, matje dhe provë.*

**BAZA LIGJORE:**

1. Gërmat g) dhe gj), të nenit 8, nenet 66, 67, 70, 71 dhe 72 të Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, (**ligji 9918/2008**);
2. Ligji Nr.44/2015 “Për Kodin e Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” (**ligji 44/2015**);
3. Plani Kombëtar i Frekuencave miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 277, datë 29.3.2017.
4. Rregullore nr. 30 datë 05.12.2013 “Për dhënien e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 2395 datë 05.12.2013.

5. Rregullore e Brendshme e Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me VKD nr.7, datë 16.02.2017;

### **KËSHILLI DREJTUES:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor i përbërë si më poshtë:

1. Aplikimi i sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a, për përdorim frekuencash në brezin 800 MHz për kërkim, matje dhe provë, për 3 (tre) stacione;
2. Relacioni Shpjegues mbi trajtimin e çështjes;
3. Projekt-Aktin vendimarrës të Këshillit Drejtues në përfundim të shqyrtimit të aplikimit, të përgatitur nga struktura e ngarkuar për trajtimin e çështjes;

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

### **VËREN:**

1. Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a, në datën 30.09.2019 ka paraqitur në modulën e aplikimeve online tre aplikime për caktim dhe përdorim frekuencash në brezin 3600-3800 MHz për tre stacione, për kërkim, matje dhe provë. Aplikimet janë riparaqitur të saktësuar në datën 07.10.2019 me nr. reference AKEP-2019-SKP-000022, AKEP-2019-SKP-000023 dhe AKEP-2019-SKP-000024, dhe janë protokolluar në AKEP me nr. 2142 prot. datë 07.10.2019.
2. Referuar të dhënave të deklaruara në formularët e aplikimit të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a, kërkesa teknike e sipërmarrësit përmbledhet si më poshtë:
  - **Nr. i stacioneve fikse të kërkuara: 3 (tre)**  
Tre stacionet kërkohet të vendosen në Tiranë, përkatësisht në zonat: 1. Cell on Wheels - Mobile Base, 2. Station (Tiranë) Tirana MTX-1 dhe 3. ish-Blloku.
  - **Frekuencat e kërkuara:**  
Sipërmarrësi ka aplikuar për caktim dhe përdorim të brezit të frekuencave 3600-3800 MHz, për frekuencat e punës 3600-3700 MHz, pra 20 kanale secili nga 5 MHz, në total 100 MHz i paçiftuar, për kërkim, matje dhe provë.
  - **Qëllimi i përdorimit të sistemit:**  
Siç deklarohet nga sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a në aplikimin e tij kërkon caktimin e ketyre frekuencave për kërkim, matje dhe provë, me synimin e testimit të këtij brezi frekuencash, konkretisht:
    - Testim i teknologjisë 5G New Radio.
    - Testim i konceptit Massive MIMO.
    - Testim i Shpejtësive Maksimale me Carrier Aggregation LTE+ 5G New Radio.
    - Testim i latency
  - **Afati i kërkuar nga Vodafone Albania sh.a: 2 muaj**
3. Pas shqyrtimit paraprak të aplikimit të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a për përdorim frekuencash në brezin 3600-3800 MHz për qëllime studimi, kërkimi, provë dhe eksperimentimi, për 3 (tre) stacione, për një periudhë 60 ditore, konstatohet se ato janë

paraqitur në formën e kërkuar të përcaktuar sipas Rregullores nr. 30 datë 05.12.2013 “Për dhënien e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave”. Përmbajtja e aplikimit për frekuencat e kërkuara, është në përputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 277 datë 29.3.2017.

4. Aplikimi i sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a, vjen në përputhje me pikën 3, të Nenit 72, të Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se: AKEP lëshon autorizime individuale për përdorimin e frekuencave për qëllime kërkimi, matjeje dhe prove të pajisjeve të radiokomunikimit për një zonë të kufizuar mbulimi dhe për një periudhë kohore jo më shumë se 90 ditë. Në mbështetje të këtij parashikimi ligjor, është përcaktuar gjithashtu dhe në pikën 3 të Nenit 6 të Rregullores nr.30 për “Dhënien e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave”, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.2395, datë 05.12.2013, se kohëzgjatja e Autorizimit Individual, në rastet kur frekuencat kërkohet të përdoren për qëllime kërkimi, matjeje dhe prove të pajisjeve të komunikimit për një zonë të kufizuar mbulimi, do të jetë jo më e madhe se 90 ditë.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në sa më sipër, në mbështetje të nenit 72 të Ligjit nr. 9918/2008 i ndryshuar, të Ligjit nr. 44/2015, si dhe të pikës 3, të nenit 6, të Rregullores nr.30, datë 05.12.2013, “Për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave”, si dhe në eksperiencat e mëparshme, Këshilli Drejtues i AKEP,

### **V E N D O S I:**

1. Të pajisë sipërmarrësin Vodafone Albania sh.a me Autorizim Individual për përdorim frekuencash në brezin 3600-3800 MHz, sasi spektri 100 MHz i paçiftuar, ndarja 3600-3700 MHz, për kërkim, matje dhe provë, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Afati për përdorimin e këtyre frekuencave nga sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a është deri në datën 14.12.2019.
3. Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a, me mbarimin e afatit të vlefshmërisë, duhet të njoftojë AKEP për përfundimin e përdorimit të këtyre frekuencave.
4. Ngarkohet Drejtoria e Autorizimeve për njoftimin e këtij vendimi dhe dërgimin e Autorizimit Individual sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**KRYETAR**

**ANËTAR**

**ANËTAR**

**ANËTAR**

**Ilir Zela**

**Ketrin Topçiu**

**Edlira Dvorani**

**Xhoana Lilaj**